



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**RREGULLORJA E PROGRAMIT MËSIMOR TË CIKLIT TË DYTË TË  
STUDIMEVE:**

**MP NË INFERMIERI PATOLOGJIKE**

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, dhe Statutit e Rregullores së Universitetit ‘Ismael Qemali’ të Vlorës dhe mbështetur në “to”.

**Neni 1**

*Emërtimi dhe statusi i programit*

Programi mësimor Master Profesional në Infermieri Patologjike është program i ciklit të dytë të studimeve, i ofruar nga Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit Publik në Universitetin ‘Ismael Qemali’ Vlorë, miratuar nga Këshilli i Akreditimit me vendim nr. 196 dt. 24-06-2011, hapur me vendim të MAS Nr. 398, dt.10-08-2011 dhe me VKM Nr.672, datë 14.09.2011, dhe publikuar në Fletoren zyrtare Nr.136, datë 4.10.2011

Ky program mësimor është i organizuar në një vit akademik (2 semestra) dhe në përfundim të tij studentët grumbullojnë 60 ECTS dhe marrin diplomën: MP në Infermieri Patologjike

**Neni 2**

*Objektivat formuese të programit të studimit Master Profesional në Infermieri Patologjike*

Programi i studimit: *MP në Infermieri Patologjike* synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e infermierisë patologjike. Ai ka për objektiva të përgatitjes infermierë patologë me formim të avancuar për të ofruar kujdes shëndetsor të kualifikuar për gjithë adultët që vuajnë nga patologji të ndryshme, si dhe për ndjekjen e ecurisë së tyre përgjatë rehabilitimit.

Në përfundim të këtij programi të ciklit të dytë të studimeve studentët do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për të ofruar një kujdes infermior me cilësi të lartë, bashkëkohor, të bazuar mbi gjykimin kritik të fakteve tek një spektër i gjerë pacientësh në çdo hallkë të shërbimit patologjik.

Duke përdorur një kombinim të mirë-balancuar të instruktiveve didaktike në auditor, seminareve për diskutimin e eksperiencës klinike dhe praktikës klinike të avancuar në repartet e patologjisë dhe shërbimit ambulator, studentët e FSHP në këtë program mësojnë si të masterizojnë dhe integrojnë praktikën e tyre klinike me trajnimin në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, liderhipin infermior, kërkimin klinik, informatizimin infermioristik dhe politikatat shëndetsore e sociale.

Kjo ekspertizë akademike bazohet në praktikën klinike më cilësore, duke përgatitur jo vetëm infermierët specialistë që kërkohen lokalisht për momentin, por edhe liderë infermiorë kombëtarë

Adresa /Adress: L. Hajro Cakërrri, Rr. Sulejman Delvina, Vlorë, Albania  
Tel. Fax ++35533224952

Web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

dhe ndërkombëtarë, që do të udhëheqin të ardhmen e infermieristikës, duke e rritur rolin e infermierit në shërbimin shëndetësor në përgjithësi.

**Neni 3**

*Lista e disiplinave mësimore, të ndara në module dhe veprimtari të tjera formuese.*

<b>Ndarja e moduleve sipas veprimtarive formuese</b>			
<b>Disiplinat</b>	<b>Modulet</b>	<b>Kreditet</b>	
Lëndë bazë: <b>A</b>	1.Kërkimi shkencor në Infermieristikë	5	5
Lëndë karakterizuese: <b>B</b>	1.Patologji e avancuar 2.Infermieri Patologjike	12 12	24
Lëndë ndërdisiplinore / integruese: <b>C</b>	1.Farmakologji klinike 2.Promocion shëndetësor në Infermieri 3.Infeksione nozokomiale/ Higjena Spitalore/Parandalimi i duhanpirjes 4.Menaxhim Infermieror/Cilësia e shërbimit shëndetësor	5 5 3 5	18
Lëndë plotësuese: <b>D</b>	1.Praktika profesionale në Patologjië e Adultit	6	6
Detyrimet përmbyllëse : <b>E</b>	1.Diploma (provim / temë) në Infermieri Patologjike	7	7
	<b>TOTAL</b>	<b>60 ECTS</b>	

**Neni 4**

*Plani mësimor i programit Master Profesional në Infermieri Patologjike*

Ky plan gjendet në faqen web të univlora.edu.al.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**Neni 5**

*Objektivat formues specifike të çdo disipline apo veprimtaritë e tjera formuese*

**KATALOGU I PROGRAMIT MËSIMOR MP NË INFERMIERI PATOLOGJIKE**

**INF 450 – Patologji e avancuar (12 ETCS)**

*Objektivat e modulit.*

Studeti do të jetë në gjendje të klasifikojnë dhe të diagnostikojë patologjitë kryesore kardiake, respiratore dhe endokrine, nefrologjike, reumatologjike, alergologjike, reumatizmale, neurologjike, hematologjike dhe gastro-hepatologjike .

- Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të integruar të pacientëve adultë me patologji kardiake, respiratore dhe endokrine, nefrologjike, reumatologjike, alergologjike, reumatizmale, neurologjike, hematologjike dhe gastro-hepatologjike .
- Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e patologjive të adultit.
- Të formojnë shprehi për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.
- ☞Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:
  - Të klasifikojnë dhe të diagnostikojë patologjitë kryesore kardiake, respiratore dhe endokrine, nefrologjike, reumatologjike, alergologjike, reumatizmale, neurologjike, hematologjike dhe gastro-hepatologjike .
  - Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të integruar të pacientëve adultë me patologji kardiake, respiratore dhe endokrine, nefrologjike, reumatologjike, alergologjike, ureumatizmale, neurologjike, hematologjike dhe gastro-hepatologjike .rw
  - Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e patologjive të adultit.
- ☞Të formojnë shprehi për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.

**INF – Infermieri Patologjike (12 ETCS)**

Në këtë modul studentëve u ofrohet mundësia për të rritur kapacitetet në fushën e kujdesit infermior në adultë dhe moshat geriartrike në ndjekjen dhe kujdesit infermior në patologjitë e adultit. Integrimi i praktikimit të teknikave të reja infermiore, i zgjerimit të koncepteve për stadet e zhvillimit human, i pat-fiziologjisë, i menaxhimit mjekësor e infermior në planet e asistencës infermiore që kanë në qendër kujdesin për pacientin, u japin mundësi studentëve me formim infermior të përgjithshëm të masterizojnë kapacitetin e tyre profesional si infermierë patologë.

*Objektivat e modulit.*

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞Të përvetsojnë teknikat infermiore bashkëkohore të kujdesit në sëmundjet e adultëve.
- ☞Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të sëmundjeve në adultë dhe kujdesit infermior
- ☞Të hartojnë dhe zbatojnë planet e personalizuara të asistencës infermiore në patologjitë kryesore.
- ☞Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit infermior të pacientëve adultë/geriartrikë me patologji të ndryshme.
- ☞Të njohin dhe aplikojnë teknikat infermiore më të avancuar atë kohës.
- ☞Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit infermior në fushën e këtyre patologjive.
- ☞Të formojnë shprehi për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**INF – Promocion shëndetësor në infermieri (5 ETCS)**

Promocioni shëndetësor trajton informacionin e formimit profesional në fushën e parandalimit dhe forcimit të shëndetit, sistemin e ofrimit të shërbimit shëndetësor parësor tek individit dhe komuniteti, bazat e edukimit promociional të spektrit të gjerë të çështjeve shëndetsore komunitare, monitorimin e mjedisit si dhe evidenton faktorët riskant të tyre mbi shëndetin në komunitet.

Temat janë të fokusuar në rolin e infermieres në komunitet, sfidat me të cilat ajo duhet të përballet gjatë punës me popullatat heterogjene.

*Objektivat e modulit.*

- ☞ Të njohë konceptet mbi shëndetin ,faktorët percaktues te tij
- ☞ Te njohë sjelljet e shëndetshme dhe strategjite e nevojshme per kultivimin e tyre ne komunitet.
- ☞ Te njohë artin e parandalimitdhe strategjite e edukimit dhe promocionit per te siguruar shendet per te gjithë.

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Ne fund te programit studenti eshte i afte te;
- ☞ Të njohë konceptet mbi shëndetin ,faktorët percaktues te tij
- ☞ Te njohë sjelljet e shëndetshme dhe strategjite e nevojshme per kultivimin e tyre ne komunitet.
- ☞ Te njohë artin e parandalimitdhe strategjite e edukimit dhe promocionit per te siguruar shendet per te gjithë.

**INF – Infeksionet Nozokomiale (3 ETCS)**

Në këtë modul studiohen infeksionet spitalore kryesore që prekin popullatën e spitalizuar. Nëpërmjet integritimit të njohurive mbi infeksionet nozokomiale do të trajtohen standartet bashkëkohore mbi jetën e shëndetshme, mjedisin, reduktimin të faktorëve riskantë dhe parandalimin e këtyre infeksioneve. Roli i infermieres professioniste që kujdeset për pacientët, do të fokusohet në kontekstin e individit, familjes dhe komunitetit ku ben pjese individi i shtruar ne spital

*Objektivat e modulit.*

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të njoh dhe te zbatoje me se miri masat higjeno-sanitare ne mjediset spitalore ne
- ☞ Të zbatoje rigorozisht masat antisptike nen kujdesin dhe interventet infermierore.
- ☞ Të njohë dhe aplikojë teknikat infermierore më të avancuar atë kohës.
- ☞ Të vendose ne praktike njohurite per kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve nozokomiale si dhe zbulimin e tyre

**INF – Higjena Spitalore (3 ETCS)**

Higjena Spitalore trajton informacionin e formimit profesional në fushën e parandalimit te infeksioneve ne sherbimin shendetesor spitalor si dhe rrit cilesisht nivelin higjenik te mjediseve duke krijuar kushte te pershtateshme higjenikisht dhe bakterologjikisht te pasterta si te mjediseve, aparaturave dhe vet protokollet e pastrimit dhe te procedurave te kujdesjes shendetesore.

Monitorimi higheno- sanitar i mjedisit korektesia ne zbatimin e kriterëve sanitare te asepsise si dhe evidentimi faktorët riskant mbi shëndetin ne keto institucione ben te mundur prevenimin e infeksioneve spitalore te pacientet si dhe te stafi shendetesor.

Temat janë të fokusuar në rolin e profesionistit në komunitet spitalore per zbatimin e kriterëve dhe protokolleve te asepsise.

*Objektivat e modulit.*

- ☞ Të njohë konceptet mbi higjenën spitalore ,normat higjeo-sanitare
- ☞ Të njohë protokollet,kriteret për parandalimin e ndotjes bakterologjike si te ambjenteve,ajri ,uji,ushqimi,ashtu edhe të procedurave te kujdesjeve infermierore
- ☞ Të rritet përgjegjshmeria ne aplikimin e detyres dhe kujdesjeve duke zbatuar rigorozisht masat dhe masat mbrojtese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

☞ Te kete impakt efektiv ne parandalimin e infeksioneve ne sherbimin shendetesor spitalor si për pacientët dhe profesionistët.

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të kenë njohuri te plota për zbatimin e normave higjeno-sanitare
- ☞ Të parandaloje faktoret e riskut
- ☞ Të rrisin efektshem kontrollin për evidentimin e faktoreve riskante duke shmangur patologjite infektive spitalore

#### INF – Parandalimi i duhanpirjes (3 ETCS)

Lënda është ngritur me një qasje pragmatike për një te ardhmeje pa duhan, ne te cilen asnje European nuk do te duhet te vuaje nga semundje te lidhura me duhanin dhe vdekje te parakohshme. Është e rëndësishme që të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor të njihen me teknikat më të fundit për të ndihmuar pacientët e tyre me ndërprerjen e pirjes së duhanit dhe që të ndihen rehat duke përdorur terapitë e bazuara në prova gjatë praktikës së përditshme klinike. Duhanpirja përbën një varësi të fortë, dhe qëllimi ynë është të krijojmë një koherencë të gjerë midis aktiviteteve parandaluese për duhanin, si dhe promovimin e politikave gjithëpërfshirëse të kontrollit të duhanit në nivel europian dhe kombëtar. Nderhyrjet per ndërprerjen e duhanpirjes kane nje ndikim afatmesem mbi numrin e vdekjeve dhe per kete arsye duhen inkurajuar.

*Objektivat e modulit.*

Kjo lëndë ka për qëllim tu ofrojë profesionistëve të kujdesit shëndetësor njohuritë e praktikave më të mira të bazuara në prova, për të ofruar trajtim të duhanit tek pacientët e tyre. Ky kurs konsolidon provat dhe këshilla praktike për përfshirjen e këtyre provave në praktikën klinike dhe bën rekomandime për ndërhyrje efektive të duhanit për të përmirësuar rezultatet shëndetësore.

#### INF – Menaxhimi infermieror (5 ETCS)

Kjo lëndë trajton konceptet bazë, metodat dhe instrumentet e menaxhimit mjekesor. Jepen njohuritë bazë mbi drejtimin dhe organizimin e zhvillimit të projekteve shëndetsore, mbi evidencat e veprimtarisë infermiore dhe ndërhyrjes për përmirësimin e impaktit të personelit infermieror. Studentët pajisen me njohuritë e nevojshme për të kuptuar mekanizmin financiar mbi të cilin funksionon veprimtaria spitalore dhe shërbimi mjekësor në përgjithësi.

Studentët që do të ndjekin këtë lëndë do të kenë kualifikimin e mjaftueshëm për të performuar në detyrën e kryeinfermierëve të reparteve të ndryshme.

*Objektivat e modulit.*

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të shërbimit shëndetsor parësor dhe dytësor.
- ☞ Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e menaxhimit infermieror dhe ekonomisë shëndetsore.
- ☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistemin shëndetsor.

#### INF – Cilësia e shërbimit shëndetësor (5 ETCS)

Ky modul e pajis studentin me kapacitetet e nevojshme për vendosjen e pacientit në qendër të shërbimit infermieror, nëpërmjet një komunikimi dhe qëndrimi etik të personalizuar, si dhe rritjes së standarteve të cilësisë dhe sigurisë së shërbimit infermieror.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

*Objektivat e modulit.*

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të ketë përvetsuar teknikat e komunikimit me kategoritë më problematike të pacientëve.
- ☞ Të njohë standartet etike të komunikimit dhe vendim-marrjes.
- ☞ Të vlerësojë dhe monitorojë standartet e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit shëndetsor.
- ☞ Të përdorë mjetet bazë të cilësisë në projekte klinike të vogla.

**INF – Farmakologji klinike (5 ETCS)**

Në këtë modul studentët do të marrin njohuri të avancuara në fushën e farmakologjisë klinike, duke e trajtuar administrimin e medikamenteve sipas rasteve klinike të grupeve të ndryshme të sëmundjeve.

*Objektivat e modulit.*

- ☞ Të hartojnë planet e kujdesit infermieror gjatë terapisë së sëmundjeve të ndryshme.
- ☞ Të bëjnë diferencimin e kujdesit dhe trajtimit midis rasteve klinike të ndryshme të të njëjtës sëmundje.
- ☞ Të përzgjedhin kujdesin e duhur në rastet klinike me disa terapi të sëmundjeve të ndryshme njëkohësisht.
- ☞ Të njohin konceptet e farmakovigjilencës dhe farmakoekonomisë
- ☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të integruar të pacientëve.
- ☞ Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e farmakologjisë klinike.

**INF – Kërkimi shkencor në Infermieristikë (5 ETCS)**

Epidemiologjia: Ky modul studion adresimin e çështjeve të tilla si rritja apo ulja e sëmundjeve të ndryshme në periudha të ndryshme kohore, në popullata të ndryshme, si dhe në subjekte të ndryshme brenda të njëjtës popullatë.

Metodologjia e kërkimit shkencor në Infermieri: Në këtë modul trajtohen teknikat dhe metodat bazë me të cilat operohet në fushën e kërkimit shkencor dhe specifikat e studimeve shkencore infermierore.

*Objektivat e modulit.*

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të hartojnë dhe zbatojnë një kërkim shkencor klinik dhe komunitar.
- ☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të studimeve shkencore infermieristike.
- ☞ Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e infermieristikës.
- ☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.

**INF – Praktikë profesionale në Patologji (6 ETCS)**

Praktika infermierore në patologjitë e adultëve është guri i themelit në formimin e Infermierit Patolog të profesionalizuar. Ajo u jep mundësinë infermierëve që ndjekin këtë program studimi të aplikojnë dhe perfeksionojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e fituara paraprakisht gjatë vitit të parë të këtij programi mësimor. Studentët do të aftësohen në arsyetimin klinik dhe do të zhvillojnë kapacitete në vlerësimin dhe menaxhimin e pacientëve nëpërmjet marrjes në ngarkim të kujdesit infermieror të pacientëve adultë. Duke punuar së bashku me stafin infermieror të reparteve të ndryshme të patologjisë dhe pedagogët mbikëqyrës, studentët do të fitojnë vet-besimin e duhur për të punuar në mënyrë të pavarur si hartues, menaxhues dhe koordinatorë të kujdesit shëndetsor patologjik.

**INF 493 – Diplomimi në Infermieri Patologjike (7 ETCS)**

Formimi i studentit në programin mësimor MP në Infermieri Patologjike mbyllet me provim formues ose me prezantimin e një punimi shkencor të pavarur ose nën udhëheqjen e një pedagogu. Për realizimin e këtij punimi shkencor studenti do të marrë të dhënat nga repartet e Patologjisë të shërbimit parësor dhe dytësor, në të cilat do të kryejë praktikën profesionale.

Tematika e punimeve shkencore do të përzgjidhet nga aspektet e ndryshme të menaxhimit infermieror të patologjiive ne adultë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**Neni 6**

*Syllabysset e ofruara studentëve.*

Syllabysset e lëndëve /moduleve të ofruara për studentët nga Departamenti i Infermierisë janë paraqitur në mënyrë të detajuar nga faqja 12 deri në faqen 80 të këtij dokumenti, dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.

Programi i plotë i kurrikulave mësimore të ofruara për studentët e Departamentit të Infermierisë për programin MP në Infermieri Patologjike mund të tërhiqet tek sekretaria mësimore e departamentit, pas pagesës përkatëse.

**Neni 7**

*Format dhe organizimi i studimit të programit MP në Infermieri Patologjike*

Në programin mësimor MP në Infermieri Patologjike veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në:

- mësim në auditor (leksione, ushtrime, seminare, laboratore),
- studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj)
- veprimtari të tjera (praktika mësimore dhe profesionale). (VKM Nr.41, dt.24.01.2018, pika 2.4)

Leksionet, seminarat dhe laboratorët zhvillohen në ambientet e Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit Publik, godina "D".

Praktikat mësimore dhe profesionale zhvillohen në institucionet shëndetsore parësore dhe dytësore nën drejtimin e pedagogut të caktuar. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, punonjësi mësimor që e drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet.

Grupet mësimore të këtij programi organizohen si më poshtë: (VKM Nr.41, dt.24.01.2018, Tabela Nr.2)

Grup mësimor për leksione:	80-100 studentë.
Grup mësimor për seminare,	25 studentë.
Grup mësimor për laboratore	20 studentë.
Grup mësimor për praktika mësimore / profesionale	20 studentë.

**Neni 8**

*Format e provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët.*

Programi mësimor MP në Infermieri Patologjike parashikon në total 9 vlerësime përfundimtare të dijeve, duke përfshirë vlerësimet përfundimtare të lëndëve mësimore, të praktikës profesionale dhe provimit të diplomës / tezës së masterit.

Për modulet e koordinuara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit.

Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, provimet e kursit, provimet e formimit, provimet praktike (prezantime të procedurave të ndryshme në mulazhe apo pacientë realë), temat e diplomave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesëshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final). (VKM Nr.41, dt.24.01.2018, pika 2.1)

Kontrolli i dijës së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

- a) me shkrim,
- b) me gojë,
- c) i kombinuar, me shkrim e me gojë

duke u mbështetur në programin mësimor. Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet minimalisht me një detyrë / projekt kursi (punë e pavarur) dhe një provim përfundimtar, plus kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën, pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo.

Në përfundim të programit të studimit studentit i njehsohet Nota Mesatare e Ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

### **Neni 9**

#### *Kushtet për tu konsideruar kalues në një lëndë*

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ... , 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese.

Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabys, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është  $\geq 40\%$  në të gjitha modulet. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të Departamentit të Infermierisë.

Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar  $\geq 40\%$  jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar

### **Neni 10**

#### *Organizimi i praktikës në programet e ciklit të dytë të studimit*

1. Praktikrat profesionale të programit të ciklit të dytë të studimeve në Departamentin të Infermierisë zhvillohen në institucionet e Shërbimit Shëndetësor Dytësor (në bazë të marrveshjeve paraprake me këto institucione), sipas profilit të përgatitjes së studentit.
2. Kohëzgjatja e praktikës mësimore / profesionale në studimet master është prej 3 muajsh.
3. Praktikrat profesionale e studentëve të Masterit Profesional udhëhiqen prej Shefave të Pavionit, të miratuar prej departamentit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

4. Studentët duhet të paraqiten në pavion rregullisht për tu angazhuar në detyrat e caktuara prej shefit dhe kryeinfermieres së pavionit, të shpërndarë në turne të ndryshme. Për nga detyrat që u ngarkohen ata konsiderohen si gjithë infermierët e punësuar në institucion.
5. Sipas VKM Nr.41, dt.24.01.2018, pika 2.5/iv studentëve të programit Master Profesional iu njihen si kredite orë e punës të zhvilluara në institucionet e Shërbimit Shëndetësor Parësor dhe Dytësor, pas dokumentacionit të plotë të paraqitur prej tyre në sekretariatë mësimore të FSHP (Vërtetimit nga Drejtorja e Spitalit ku kanë punuar / janë praktikuar dhe Shefi i Shërbimit përkatës).
6. Në përfundim të praktikës profesionale në këtë cikël studimesh, pedagogu i praktikës dorëzon në sekretarinë mësimore vlerësimin e performancës gjatë praktikës për secilin student dhe frekuentimin e lëndës.
7. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces mësimor.
8. Përpara provimit të praktikës pedagogu i praktikës profesionale dorëzon në sekretarinë mësimore:
  - o Raportin e frekuentimit të praktikës profesionale nga studentët (rregjistri akademik).
  - o Skedën e vlerësimit të performancës së studentit në praktikën profesionale

#### **Neni 11**

##### *Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve*

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

- 1.Në bazë të rregullores së UV, kontrolli i njohurive në programet mësimore të FSHP bëhet me dy provime paraprake dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit apo skedave të vlerësimit në laboratore dhe praktika mësimore.
- 2.Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim.
- 3.Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
- 4.N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
- 5.Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
- 6.Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

#### **Neni 12**

##### *Rikontrollimi i dijeve të fituara*

Studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet duhet tu nënshtrohen kontrolleve për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara, kontrolle këto për të garantuar mosvjetërimin e dijeve dhe përditësimin e tyre për kreditet e fituara më parë.

Edhe studentët që u kanë zgjatur studimet më shumë se dy vjet përtej kohës normale të fitimit të diplomës për MP në Infermieri Patologjike, para dhënies së tezës së masterit iu kontrollohen kreditet e fituara.

#### **Neni 13**

##### *Detyrimet e mundshme, që lidhen me frekuentimin.*

- Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 80%.
- Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%.
- Frekuentimi i praktikave spitalore është i detyrueshëm në masën 80%.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

- Frekuentimi i laboratoreve është i detyrueshëm në masën 100%. Nëse, për arsye objektive, do të ketë mungesa në orë të veçanta laboratorike, do të gjendet koha e përshtatshme për zëvendësimin e tyre.

**Neni 14**

*Shkeljet e integritetit akademik*

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Fakultetin e Shëndetit Publik - UV duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhesh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.

2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe përifrazimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë përifrazimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

3. Mashtrim në raporte laboratorike duke fallsifikuar të dhena apo duke dorëzuar të dhena të pabazuara në punën vetjake të studentit është shkelje.

4. Fallsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterike duke përfshirë modifikimin e skedar kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratorike dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, apo ese origjinale ose referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëkëzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**Neni 15**

*Karakteristikat e Detyrave/Projekteve të kursit*

Detyrat dhe projektet e kursit në programin MP në Infermieri Patologjike janë dy tipesh: Raportime rasti dhe Studime kros-seksionale (individuale apo në grup). Kërkesat për secilin tip paraqiten më poshtë:

**RAPORTIMI I RASTIT**

*Gjeneralitetet* – emri, mbiemri, mosha, venbanimi

*Epidemiologjia* (përhapja) e sëmundjes – ku haset me shpesh: në ç'vend dhe në ç'përiudhe te vitit.

*Etiologjia* (shkaktarët) e sëmundjes – cili ka qenë shkaku i sëmundjes së pacientit që po raportohet.

Veç kësaj do të përmenden edhe shkaktarët e tjerë të kësaj sëmundjeje sipas literaturës.

*Klinika* e sëmundjes:

○ Gjithë paraqitja klinike e sëmundjes në momentin e raportimit

○ Ecuria klinike që nga momenti i fillimit të sëmundjes (anamnezis morbi)

Gjatë paraqitjes klinike të sëmundjes do të evidentohen tiparet klinike karakteristike të sëmundjes që paraqet pacienti, së bashku me shenja të tjera klinike që nuk janë tipike apo nuk janë pjesë e kësaj sëmundjeje.

○ Paraqiten gjithë problemet e tjera shëndetsore apo të stilit të jetesës që ka pacienti, si dhe mënyrat e mundshme sesi ato mund të kenë ndikuar në klinikën apo trajtimin e sëmundjes bazë (anamnesis vitae)

○ Pas kësaj, duke iu referuar literaturës, do të paraqitet spektri i plotë i tipareve klinike dhe komplikacioneve të sëmundjes në fjalë.

*Diagnostikimi:*

▪ Do të paraqitet diagnoza klinike e vendosur nga mjeku përkatës dhe do të argumentohen arsyet pse është vendosur kjo diagnozë.

▪ Do të renditen ekzaminimet që ka kryer pacienti dhe do të referohen nga literatura të gjitha ekzaminimet e mundshme, duke nënvizuar ekzaminimin kyç në vendosjen e diagnozës së kësaj sëmundjeje.

*Trajtimi:*

▪ Do të paraqitet ecuria e trajtimit që nga fillimi i sëmundjes, çfarë është ndryshuar në këtë plan trajtimi apo plan asistence dhe pse.

▪ Do të paraqitet trajtimi aktual i të sëmurit, duke argumentuar arsyet pse është vendosur në këtë plan asistence në momentin aktual të zhvillimit të sëmundjes.

▪ Do të referohen nga literatura planet e tjera të mundshme të asistencës së të sëmurit. Do të krahasohen ato me planin aktual të asistencës të pacientit.

▪ Do të jepen rekomandimet e mundshme për përmirësimin e planit aktual të asistencës së pacientit.

*Prognoza* (parashikimi mbi ecurinë e sëmundjes):

○ Do të referohet prognoza e pacientit sipas mjekut që e ndjek.

○ Do të bëhet një parashikim sipas mendimit personal të referuesit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETTIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**STUDIMET CROS-SEKSIONALE**

*Hyrja* – bëhet një parashtrim i shkurtër i përmbajtjes së punimit, duke theksuar çfarë sjell të re ky studim, çfarë ka interesante dhe të rëndësishme që t'ia vlejë për tu lexuar.

*Fjalët kyçe* – emërtimet kryesore dhe më të shpeshta të punimit.

*Referimi i literaturës* – bëhet përmbledhja e literaturës së studiuar mbi temën e punimit. Përmenden punime të ngjashme dhe krahasohen konkluzionet. Trajtohet gjerësisht problemi nga ana teorike dhe studimore.

Referimi i literaturës së huaj bëhet me përpikmëri. Për çdo paragraf vendoset numri korrespondues me literaturën nga është marrë, që është listuar tek sektori 'Referencat'. Nuk lejohet citimi i asnjë paragrafi i pashoqëruar me referimin përkatës.

*Qëllimi dhe Metoda* – paraqitet çfarë qëllimi ka studimi, objektivat e përgjithshme dhe specifike, si dhe metodat dhe instrumentat e përdorur për realizimin e këtyre qëllimeve dhe objektiveve. Përshkruhet me hollësi e gjithë metodologjia e punës, çdo veprim i kryer, p.sh: studimi i kartelave, krahasimi i protokolleve të trajtimit, aplikimi i planeve të asistencës, plotësimi i pyetsorëve, mbledhja e të dhenave nga statistikat, shqyrtimi klinik i rasteve.

*Rezultatet* – paraqiten të gjitha të dhenat e mbledhura në tabela dhe në paraqitje grafike. Grafikët shoqërohen me komente sqaruese.

*Diskutimi* – komentohen të dhenat e mbledhura në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektiveve.

*Konkluzionet dhe Rekomandimet* – bëhet një përmbledhje e rezultateve të evidentuara dhe jepen rekomandimet për përmirësime në politikat shëndetsore aktuale apo për ngritjen e politikave të reja (parandaluese, diagnostikuese, terapeutike, etj)

*Referencat* – çdo libër referohet me titull, emër autori, vit botimi, ISBN dhe faqet nga është marrë citimi. Nëse referimi është nga interneti, vendoset adresa e plotë e internetit. Listimi i literaturës bëhet sipas renditjes alfabetike.

☞ *Temat do të shkruhen në formatin Times New Roman 12.*

☞ *Një kopje elektronike do të niset me e-mail*

☞ *Një kopje e shkruar do ti dorëzohet pedagoges*

☞ *Punimet do të prezantohen në formatin Ms.PowerPoint gjatë dy javëve të fundit të semestrit.*

☞ *Çdo student do të prezantojë pjesën me të cilën ka punuar më shumë.*

☞ *Pas prezantimit do të ketë pyetje dhe diskutime.*

☞ *Vlerësimi në fund është individual.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

*Rregullat për paraqitjen e detyrave / projekteve të kursit:*

- Të gjitha punimet duhet të dorëzohen në kohën e caktuar. Ato duhet të tregojnë që në paraqitje një stil profesionist.
- Duhet të jenë të shtypura. Punët me shkrim dore nuk do të pranohen dhe studenti do të vlerësohet automatikisht me 0 pikë.
- Në punime gjuha duhet të jetë zyrtare, letrare dhe neutrale. Ndalohen rreptësisht përdorimet e zhargoneve të pa argumentuara, shprehjet që rëndojnë etikën profesionale dhe njerëzore, kërcënimet, fyerjet, sharjet, etiketimet, tendencat politizuese, trajtimet jashtë tematikave të kërkuara, etj.
- Punët duhet të kenë një volum me më tepër se 3 faqe (format A<sup>4</sup>, shkrimi Times New Roman, 12 pt) dhe në faqet e para duhet të jenë të shënuara pa gabime drejtshkrimore:

Emri i Studentit Titulli i punimit Kursi dhe grupi përkates i studentit Data e dorëzimit të punimit sipas grafikut të shpallur Emri i instruktorit Numri i faqeve
--

*Elementët e vlerësimit të detyrës së kursit do të përfshijnë:*

Thelbësore:

- Respektimin e strukturës së punimit shkencor
- Renditjen e argumenteve akademiko-shkencorë
- Mënyrat specifike të trajtimit të çështjeve në raport me realitetin shqiptar

Ndihmëse:

- Ideja e zgjedhur
- Mënyra e organizimit të punimit
- Logjika e përdorimit të koncepteve
- Përputhja me objektivat e programit mësimor
- Argumentet dhe analiza kritike

### **Neni 16**

#### *Karakteristikat e Tezës së Masterit*

Projektet e Tezës së Masterit duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- Të jenë minimalisht studime kros-seksionale, (klinike apo komunitare),
- Të jenë studime deskriptive apo analitike.
- Tematika e punimeve shkencore duhet të përfshijë vetëm fushën e Kujdesit Infermieror në Pediatri.
- Punimet duhet të jenë origjinale në realizim, por sigurisht që mund të mbështeten në punime të mëparshme të të njëjtës fushë studimi.
- Me udheheqje shkencore apo krejtësisht të pavarura.
- Të plotësojnë kërkesat e renditura në Nenin 15 për studimet kros-seksionale dhe rregullat e projekteve të kursit.
- Përpunimi statistikor mjafton të jetë i një niveli bazë (p.sh: është e mjaftueshme që konkluzionet të nxirren në bazë të diferencës së risqeve).

**Paraqitja e temave të diplomës së studentëve të MP në Infermieri Patologjike duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

1. Shkresa e pranimit të temës nga udhëheqësi shkencor.
2. Tema e plotë (60-100 faqe)
3. Kopërtina e përcaktuar (formati gjendet në sekretari)
4. Faqja e fundit e kopërtinës duhet të përmbajë abstraktin e temës (shqip dhe anglisht) sipas rubrikave të mëposhtme:
  - background-i
  - qëllimi dhe objektivat
  - materiali dhe metoda
  - rezultatet
  - konkluzionet
  - rekomandimet
- a. Në faqen e parë të temës dhe të autoreferatit duhet të paraqitet një përmbledhje e shkurtër (vetëm 1 faqe) e rëndësisë së fushës së zgjedhur për studim dhe risive që sjell studimi i kryer.
- b. Kërkesat e shkrimit të temës:
  - Lloji i shkrimit - times new roman 12 pt,
  - Line spacing - 1.0,
  - Margins - Office 2003 Default = top:1”, bottom:1”, left:1.25”, right:1.25”.
- c. Referimet e literaturës të paraqiten me numra dhe të renditen sipas rradhes së përmendjes në studim.
- d. Autoreferati (20 faqe) – Përmbledhja e të dhënave kryesore të studimit.
- e. Vlerësimi i udhëheqësit shkencor mbi temën e paraqitur.

**Neni 17**

*Modalitetet për dhënien e diplomës në programin MP në Infermieri Patologjike*

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të dytë të studimeve në programin MP në Infermieri Patologjike në Fakultetin e Shëndetit Publik – UV janë:

1. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat:
  - e formimit të përgjithshëm
  - karakterizuese
  - ndërdisiplinore, të lidhura me disiplinat karakterizuese
  - praktikën profesionale
2. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në:
  - një prej moduleve të disiplinave me zgjedhje
3. Studenti duhet të ketë vlerësim ‘kalues’ në provimin/tezën e diplomës.
4. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar minimalisht 60 ECTS (kredite).

**Neni 18**

*Modalitetet e marrjes së temës studimore si Detyrim Përmblyllës*

Mbrojtja e Diplomës në përfundim të programit të master profesional parashikohet me provim formues ose me përgatitjen e një teze diplome.

- Mesatarja e notave për marrjen e temës së diplomës përcaktohet me vendim të SA, pas propozimeve të departamentit.
- Studentëve të programeve master profesional u llogaritet mesatarja e ponderuar në bazë të notave të marra gjatë semestrit të parë.
- Studentët të cilët gjatë semestrave paraprakë të studimeve kanë një mesatare aritmetike të lëndëve më të ulët se mesatarja e parashikuar nga SA, ose që nuk dëshirojnë të realizojnë temë diplome, do të diplomohen nëpërmjet provimit të përgjithshëm formues.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**Neni 19**

*Mbrojtja e diplomës me provim formues të përgjithshëm*

1. Studentët që nuk e arrijnë mesataren e përcaktuar me vendim SA diplomohen me provim të përgjithshëm teorik.
2. 3 muaj përpara sezonit të provimit të diplomës, departamenti përcakton lëndët e formimit karakterizues dhe integruese të programit, që do të përfshihen në provimin e përgjithshëm përfundimtar. Titullarët e lëndëve dorëzojnë në departament temat e përzgjedhura për secilën lëndë, nga të cilat do të nxirren pyetjet e provimit.
3. Lista e temave mësimore që do të pyeten në provimin e diplomës vihet në dispozicion të studentëve 2muaj përpara sezonit të diplomës (fotokopje, afishim në ambiente të dukshme, web-i i UV, facebook-u i FSHP).
4. Informimi i studentëve për formën e vlerësimit të njohurive (formën e provimit) bëhet 2 muaj përpara përfundimit të semestrit.
5. Hartimi i tezës së provimit të diplomës:
  - Banka e pyetjeve për secilën lëndë, së bashku me pikët maksimale për çdo pyetje, do të dorëzohet e firmosur prej titullarit të lëndës tek drejtuesi i departamentit, 1 javë përpara sezonit të diplomimit.
  - Pyetjet janë të formuluar përgjithësisht në formë quiz-esh dhe pyetjesh shtjelluese. Çdo pyetje duhet të shoqërohet me numrin e pikëve maksimale, që mund të merren prej saj.
  - Formulimi i tezës së provimit bëhet nga Drejtuesi i departamentit. Ai përzgjedh nga banka e pyetjeve një përqindje të caktuar të pyetjeve prej secilës lëndë, sipas vlerës specifike të krediteve që ka lënda: lëndët me më shumë kredite do të kenë edhe përqindjet më të larta të pikëve në provim. Në total shuma e pikëve maksimale të të gjitha pyetjeve të përfshira në tezën e provimit të diplomës është 100 pikë.
  - Minimalisht hartohen 6 (gjashtë) teza provimi.
6. Elementet e tezës së provimit janë:
  - Emri: Teza e provimit të diplomës në programin .....
  - Sezoni i diplomimit
  - Varianti i tezës
  - Drejtuesi i departamentit: emri, firma
  - Dekani i FSHP: emri, firma, vula e njësisë kryesore.
  - Çdo pyetje duhet të shoqërohet me numrin e pikëve maksimale, që mund të merren prej saj.
  - Pyetjet e të njëjtës lëndë janë të grupuara në një faqe. Çdo fletë e tezës ka pyetje vetëm të një lënde. Teza ka aq fletë sa lëndë janë përfshirë në të (plus fletët e bardha që mund tu duhen studentëve për të zhvilluar përgjigjet).
7. Pas marrjes në dorëzim të procesverbalit të vlerësimit të provimeve, drejtuesi i departamentit u komunikon privatisht studentëve sasinë e pikëve të marra dhe notën përkatëse.
8. Studenti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për vlerësimin e marrë nga pedagogu që ka bërë korrigjimin.
9. Në rast pakënaqsie student i ndjek procedurën e apelit të notës, si në provimet e lëndëve.
10. Procesverbali përfundimtar i vlerësimeve në provimin e diplomës dorëzohet në sekretari nga drejtuesi i departamentit. Ai firmoset nga gjithë pedagogët që kanë marrë pjesë në korrigjimin e tezës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**Neni 20**

*Procedura e diplomimit*

1. Studentët që kanë plotësuar detyrimet e një programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit pajisen me diplomë, e cila është një dokument zyrtar.
2. Diplomat e ciklit të dytë shoqërohen me suplementin. Ai përshkruan në veçanti, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.
3. Përmbajtja dhe forma e Diplomës, si dhe formati i Suplementit të Diplomës është i përcaktuar nga MASR në udhezimin përkatës.
4. Modalitetet e prodhimit dhe shpërndarjes së diplomave përcaktohen në Rregulloren dhe Statutin e UV.
5. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari gjatë ceremonisë së diplomimit ose në zyrën e Kryesekretares së FSHP, sipas Rregullosës së UV (neni 64).

**Neni 21**

*Shkeljet e rregullave të fakultetit*

Shkelje të rregullave të FSHP konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çenojnë personalitetin e mësimdhënies dhe të çdo punonjësi tjetër të shkollës, normat etiko – morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, aktet e rrugaçerisë, të vjedhjes etj, kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale.

Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim;
- përjashtim nga shkolla për një vit;
- përjashtim nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës;
- përjashtim përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës.

Vendimin për përjashtimin e studentit një vit nga shkolla e merr Dekanati i Fakultetit të Shëndetit Publik.

Vendimin për përjashtimin nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasëshme) e merr Rektori i Universitetit Ismail Qemali të Vlorës, mbi bazën e propozimit të Dekanatit.

**Neni 22**

*Kushtet për procedurat e modalitetet për ndërprerjen e studimeve*

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

- Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjeko – ligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi. Dokumentat duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektorit.
- Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat e Pushtetit Lokal. Këto dokumenta duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektorit.

Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra rradhe, duhet të aplikojnë përsëri për pranim në Universitet. Vendimi merret nga një komision i ngritur nga Rektori.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**Neni 23**

*Kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve*

Procedurat transferuese në Fakultetin e Shëndetit Publik përcaktohen në rregulloren e Universitetit 'Ismail Qemali' të Vlorës. Proçedurat transferuese përfundojnë përpara fillimit të semestrit.

Studentët e Fakultetit të Shëndetit Publik - UV të cilët duan të tranferohen në universitete të tjera të vendit, në të njëjtën degë dhe sistem, paraqesin kërkesën në zyren e regjistrimit për tërheqjen e listës së notave. Pas përgjigjes së pranimit nga universiteti pritës, përcillet dokumentacioni i plotë i studentit; detyrimet e shlyera me notat përkatëse, dëftesa e shkollës së mesme, dokumentacioni i bursës, etj. Pas kryerjes së transferimit studenti humb statusin e studentit të UV.

Për studentët që duan të transferohen në FSHP, Komisioni i ekuivalentimit të moduleve dhe krediteve të programeve mësimore të FSHP, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon universiteti përkatës, përcakton detyrimet që do të ketë studenti, nëse pranohet në atë degë, sipas planit mësimor në fuqi si dhe njohjen e shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë. Keto transferime bëhen sipas akteve ligjore të miratuara nga MAS.

Fakulteti i Shëndetit Publik njih si kredite të formimeve universitare në programin MP në Infermieri Patologjike njohuri të veprimtarive formuese (module, praktika profesionale në shërbimin shëndetsor parësor dhe dytësor) të nivelit pas ciklit të parë të studimeve që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit, numrin e orëve mësimore dhe kurrikulën e modulit minimalisht me 80% të normave të ofruara nga programi mësimor i FSHP. Numri maksimal i krediteve të njohura në këtë rast nuk i kalon 30 ECTS. (kreu II, pika 7, udhezimi 15 i MAS).

Çdo student që diplomohet në programin MP në Infermieri Patologjike, ofruar nga Fakulteti i Shëndetit Publik i Vlorës duhet të ketë të paktën 30 kredite të marra në FSHP.

Programi mësimor MP në Infermieri Patologjike ka në përbërje të tij një numër modulesh të njëjta apo të ngjashme (në orë në auditor dhe në literaturën e detyruar) me programet e tjera mësimore të ciklit të dytë të studimeve në Fakultetin e Shëndetit Publik – UV dhe Fakultetin e Infermierisë – UT. Disa prej këtyre moduleve janë: Kërkimi shkencor në Infermieristikë, Cilësia e shërbimit shëndetsor, Menaxhimi infermior, Promocioni shëndetsor. Kjo e bën programin MP në Infermieri Patologjike mjaft fleksibël dhe lejon lëvizshmëri akademike jo vetëm në programet e fakulteteve të tjera, por edhe në programet e tjera të masterave profesionale në Infermieri Pediatrike dhe Infermieri Kirurgjikale, si dhe në programin Master Shkencor në Shkenca Infermiore në FSHP.

**Neni 24**

*Dispozita të veçanta*

Këshilli i Fakultetit të Shëndetit Publik – UV ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Senatin Akademik të Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë.

**Drejtuese e Departamentit të Infermierisë  
Fakulteti i Shëndetit Publik – UV**

**PhD. Dr. Majlinda Zahaj**